

I nderuar z. Ahmetxhekaj, me datë 29 qershor 2023 kemi pranuar një reagim nga ana juaj i cili synon që duke shpërndarë të pavërteta rreth BIRN të krijojë presion dhe të pengojë raportimin profesional të BIRN për çështjet e interesit publik në RTK.

Organizata jonë në dy raste në muajt e fundit ka pranuar ankesa të pabazuara të formatit SLAP të cilat janë hedhur poshtë nga KMSHK për shkak të pretendimeve të pavërteta që janë ngritur në to. Shiko rasti [1](#) dhe rasti [2](#).

Menaxhmenti i RTK-së nuk është mjaftuar me ankesa SLAP dhe ka vazhduar të nisë një fushatë me të pavërteta lidhur me proceset në të cilat emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtesia në Kosovë” kanë siguruar hapsirën transmetuese në RTK.

Duke mos u mjaftuar me faktin që bordi i RTK-së i përkrahur edhe nga një letër politike e kryetarit të Kuvendit Glauk Konjufca ka vendosur t’i përjashtojë emisionet e pavarura nga skema programore e RTK-së, ju keni nisur edhe fushatën për të tentuar që me të pavërteta ta degradoni punën 15 vjeçare të emisioneve tona duke synuar të ndërtoni narrativ që gjatë realizimit të emisioneve ka pasur parregullësi gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre.

z.Ahmetxhekaj, ju e dini se dy emisionet e prodhuara nga BIRN kanë qenë emisionet informative më të shikuara në RTK dhe kanë shumëfish më shumë çmime vendore e ndërkombëtare se i gjithë prodhimi i RTK-së që është realizuar në 24 vitet e fundit.

Ne jemi seriozisht të shqetësuar për rëndimin e situatës veçanërisht me deklaratimet tuaja të pavërteta në reagimin e fundit, në të cilin pretendoni (sidomos në fjalinë e fundit) të ngrisni paralele në mes të kontratës së nënshkruar nga BIRN me RTK dhe kontratës së RTK të nënshkruar me Reuters.

Në reagimin tuaj ju pretendoni se BIRN ka nënshkruar kontratë me RTK-në **“pa thirrje publike, por thjesht duke e pranuar një ofertë të znj. Jeta Xharra për transmetimin e 2 emisioneve në javë”**. Ky pretendim i juaj z.Ahmetxhekaj është **RRENË** sepse ne jemi përzënë nga RTK, përkundër se për kontraktimin e produkteve audiovizuale ka pasur proces i cili është zhvilluar nëpërmjet thirrjes publike që RTK e ka pasur në faqen e saj.

Ekipi ynë ka aplikuar në këtë thirrje dhe vetëm pas vlerësimit të komisionit të brendshëm, RTK ka vazhduar procedurat e prokurimit përmes negocimit direkt dhe më pas nënshkrimin të kontratës. Pra, pretendimi juaj që procesi është zhvilluar pa thirrje publike është plotësisht i pavërtetë, tendencioz dhe synon të hedhë pluhur mbi të gjithë punën profesionale të realizuar nga BIRN e të transmetuar në RTK.

Edhe pretendimi tjetër që procedurat e tenderimit në rastin e BIRN kanë qenë të mbyllura është i pavërtetë, ngase procesi i negocimit të kontratës ka rezultuar me publikimin e njoftimit për negocimin e kontratës në faqen e KRPP-së e pastaj me nënshkrimin e kontratës. Publikimi i njoftimit për kontratë e bënë këtë proces transparent dhe llogaridhënës para publikut.

Ju z. Ahmetxhekaj jeni në dijeni që tërë këto procese janë audituar dhe se procesi ka qenë në rregull sipas ligjit dhe rregullave të menaxhimit financiar, megjithatë ju vendosni që t’i shmangni faktet, të rreni dhe të lansoni akuza të pabazuara.

Në reagimin tuaj ju tentoni ta legjitimoni kontratën me Reuters duke tentuar të ngrisni paralele mes procedurës së aplikuar në këtë rast me procedurën e aplikuar në rastin e kontratës me BIRN.

Ju duhet të dini se procedura e negocimit direkt është procedurë e paraparë me ligjin e Prokurimit Publik, nëse plotësohen disa parakushte. Në rastin e lidhjes së kontratës me Reuters (Rrjetin e Lajmeve Ndërkombëtare), Auditori ka gjetur disa shkelje, që janë:

- Termat e referencës së kontratës nuk janë aplikuar sipas kërkesave të LPP-së;
- Gjatë kontraktimit, nuk janë përdorur dokumentet standarde të KRPP;
- Afati dhe kushtet e pagesës me paradhënie për çdo tre muaj janë përcaktuar sipas kërkesës së Operatorit Ekonomik (Reuters);
- RTK-ja nuk ka kërkuar garancion mbi performancën e ekzekutimit të kontratës.

Ju e dini se në rastin e kontraktimit të BIRN procedurat e prokurimit dhe thirrjes janë respektuar deri sa RTK vazhdon të shkelë ligjin dhe të paguajë kamata ligjore duke vazhduar të jetë borxhli i BIRN.

Përpos kësaj, ju po ashtu tentoni të nxirrni një listë me gjoja keqcitime të raportit të auditimit nga ana jonë. Ju sigurojmë edhe Ju e edhe publikun se secila shkronjë në artikullin tonë ka mbështetje dhe është e argumentuar bazuar në gjetjet e auditorit dhe materialet të cilat janë cituar në artikull

Në vijim po adresojmë secilin pretendim tuajin për të dhënë argumentet dhe bazën pse raportimi ynë është i saktë dhe i bazuar.

Pretendimi 1 nga z. Ahmetxhekaj

Specifikisht, në faqe 21 ZKA thotë se nuk është zbatuar vendimi i bordit i vitit 2019 për ndalesat e shpërblimeve dhe shtesave.

“Gjatë auditimit në tri raste, edhe këtë vit, kemi vërejtur se RTK-ja kishte paguar shpërblime për punonjës. Në 3 rastet kemi vërejtur se autorizimet e dhëna ishin për pozita të cilat nuk ishin pjesë e rregullores për metodologjinë e përcaktimit të ndërlikueshmërisë në punë, mirëpo ishin pjesë e Organogramit. Kosto e shpërblimeve për këta persona ishte 6,419 euro. Për këto lëvizje të stafit në pozita nuk ka dëshmi se ka pasur miratim nga bordi i RTK-së”, thotë raporti.

Fakt: Në raport ceket qartë se kjo nuk është e gjetur dhe është hequr, pra është zgjidhur gjatë procesit të auditimit, pas fakteve shtesë të prezantuara nga Menaxhmenti i RTK-së. (https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_RTK_2022_Shqip.pdf - faqe 21)

Sqarimi i KALLXO.com:

Konstatimi juaj se çështja është zgjedhur gjatë procesit të auditimit është i pavërtetë. Sipas rregullave të auditimit çështja zgjidhet gjatë auditimit nëse auditori në draft raport ka konstatuar diçka e pas komenteve auditori ka vendosur që e njëjta të largohet nga raporti final, për shkak të gabimit të Auditorit. Në këtë situatë, çështja nuk është larguar, por mbetet aty me konstatimin se veprimet kanë pasur efekt në gjysmën e parë të vitit dhe vetëm në gjysmën e dytë të vitit ajo është adresuar.

Tek pretendimi i parë, ju keni tentuar të demantoni një pjesë të shkrimit, por duke e hequr një pjesë shumë të rëndësishme të artikullit tonë që flet për atë çështje.

Pra, ne, në artikullin tonë kemi thënë që “bordi i tanishëm e kishte toleruar menaxhmentin e tanishëm i cili deri në qershor të vitit 2022 dha shpërblime dhe shtesa për të punësuarit pa miratimin e bordit”, pra kemi kallxu saktë qysh ka thënë Auditori që shkelja ka vazhduar deri në gjysmë të vitit.

Pra, fakti që një e gjetur vazhdon të jetë në raportin e Auditorit të Përgjithshëm do të thotë që është ende “ÇËSHTJE”. Auditori thotë që kjo çështje ka qenë deri më datë 7 qershor 2022, që është gjysma e vitit për të cilin është kryer Auditimi. Por, dallimi në mes të kësaj çështjeje dhe çështjeve tjera është që Auditori për këtë çështje nuk ka dhënë rekomandime se si duhet të zgjidhet, sepse ju tashmë, pas gjysmë viti, e keni zgjidhur si ÇËSHTJE. Pra, Auditori nuk ka thënë që NUK KA ÇËSHTJE, por ka thënë që ajo është zgjidhur në mes të vitit dhe nuk ka dhënë rekomandime se si duhet të adresohet gjatë vitit aktual.

Pra Interpretimi i juaj është i pasaktë kur thoni se “është zgjidhur gjatë procesit të auditimit, pas fakteve shtesë të prezantuara nga Menaxhmenti i RTK-së” sepse në rastin konkret është konstatuar që si shkelje ka ekzistuar deri në gjysmë të vitit, mirëpo pas kësaj date (07.06.2022) është zgjidhur dhe Auditori nuk ka pasur nevojë të jep rekomandime për vitin pasues.

Pretendimi 2 nga z. Ahmetxhekaj

Më tutje, shkeljet tjera serioze që kanë shkaktuar RTK-në të merr opinion të kualifikuar nga ZKA është politika e punësimit, avancimit dhe shpërblimit të punonjësve që është bërë jashtë rregullave të RTK-së në vlerën e mbi 6000 euro që janë identifikuar në shembujt që i ka inspektuar auditori.

Fakte: Raporti i ZKA-së nuk e përmend në asnjë gjetje se ka pasur punësime dhe shpërblime jashtë rregullave të RTK-së. Raporti final i referohet vetëm 5 rasteve të ushtruesve të detyrës, për të cilët kërkon shpallje të konkursit. Këtë e kemi zbatuar tashmë pasi janë shpallur konkurset e brendshme dhe të jashtme.

A mundeni të specifikoni se në cilën faqe të raportit apo në cilin rekomandim flitet për punësime dhe shpërblim?

Sqarimi i KALLXO.com:

Kallxo.com ka bazuar konstatimin për probleme në punësim dhe avancim në RTK bazuar në gjetjet e auditorit dhe nuk ka shtuar asnjë pikë as presje prej asaj çka auditori ka konstatuar. Raporti i [Auditorit](#) në faqe 20 dhe në faqe 21 i cek çështjet që ju po thoni se nuk i cekur.

Në raportin e Auditorit është shpjeguar edhe rasti kur drejtori menaxhues i ka emëruar PA KONKURS 5 persona nëpër pozita, që Në të vërtetë i bjen punësim për pozita për të cilat do të duhej të kishte konkurs. Përveç kësaj, Auditori ka konstatuar se ju i keni anuluar këto emërime, por po vazhdoni me i mbulu këto pozita me Ushtrues Detyre (UD), pra keni vazhduar mos me shpallë konkurs. Mbajtja e pozitave me UD në periudha më të gjata se gjashtë muaj është shkelje e ligjit.

Gjatë vitit 2022 në RTK, janë emëruar 5 punonjës në pozita drejtuese me autorizim të drejtorit të përgjithshëm pa u zhvilluar procedura të konkursit. Në lidhje me këto, inspektorati i punës kishte konstatuar se këto emërime nuk ishin në përputhje me rregullativen ligjore të RTK-së. Për këto avancime, RTK-ja kishte anuluar emërimet e tyre mirëpo këto raste vazhdojnë të jenë ushtrues detyre më shumë se gjashtë (6) muaj dhe ende nuk kishte hapur konkurse të brendshme për këto pozita.

Tutje [raporti](#) i Auditorit ju kritikon për politikën që ju keni zgjedhur për t'i emëruar njerëzit në pozita, e që në gjuhën shqipe i bjen 'politika e punësimit'. Për më shumë, raporti thotë që ju “rrezikoni që pozitave të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Njëherit, këto mund të ndikojnë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi”.

Për më tepër, ju nuk jeni pajtuar me gjetjen e Auditorit dhe keni dërguar sqarime shtesë, mirëpo siç e keni parë Auditori nuk është bindur dhe ka vazhduar të cilësojë këtë si shkelje. Ja çka thot Auditori pasi e ka lexuar përgjigjen tuaj: “E gjetura qëndron, pasi çështja në fjalë ka të bëjë me procedurën e aplikuar nga RTK-ja, deri në vlerësimin e Inspektoratit të punës. Pra, përzgjedhja ishte bërë duke mos aplikuar konkurset e brendshme sipas udhëzimit administrativ. Për këto avancime, RTK-ja kishte anuluar emërimet e tyre mirëpo këto raste vazhdojnë të jenë ushtrues detyre më shumë se gjashtë (6) muaj. Madje lidhur me kohëzgjatjen e ushtruesve të detyrave RTK-ja ka email zyrtar nga departamenti ligjor i saj, se kohëzgjatja e tyre nuk duhet të jetë më e gjatë se 6 muaj”.

Në fakt, ju nuk i keni adresuar këto rekomandime të Auditorit sepse, në bazë të dokumenteve që na i keni dërguar kur kemi kërkuar çasje, ju edhe sot e kësaj dite vazhdoni të keni UD udhëheqjen e administratës dhe burimeve njerëzore për më shumë se jo 6 muaj, por 1 vit të tërë.

Përveç kësaj, me BOLD në faqe 21 nënvizohet edhe “Mos zbatim i vendimit për ndalesat e SHPËRBLIMEVE dhe shtesave”. “Çështja 1” në faqe 21 përmendet 3 herë këtë çështje.

Faqet 20 dhe 21 të raportit të Auditorit thonë që keni dhënë shtesa financiare në pagë mujore për pozita që s’janë në rregullore të RTK-së. Këtu Auditori nuk e ka fjalën për pagesën shtesë për orë të natës dhe orët tjera shtesë që i rregullon ligji e jo rregulloret e RTK-së. Auditori, askund NUK përmendë orët shtesë të natës, prandaj këto orë shtesë s’i përmendë as artikulli jonë. Ju po manipuloni me fakte kur po thuani që ne kemi sugjeruar në artikull që s’duhet të paguhen orët e natës dhe orët shtesë. Aspak nuk bëhet fjala për pagesa për këto orë shtesë.

Fjala është për pagesat shtesë në pagë mujore që i keni vendosur t’i jepni ju si Drejtor i Përgjithshëm, pagesë e cila ka rregullore të caktuar të RTK-së se kur dhe se si bëhet.

Pretendimi 3 nga z. Ahmetxhekaj

Çka është për t’u çuditur është që RTK në 2022, me bordin e menaxhmentin e ri, e ka përsëritur një shkelje për të cilën ish bordi dhe ish menaxhmenti i RTK-së ishin kritikuar shumë dhe madje ishin shkarkuar. Kjo ka të bëjë me çështjen e pagesave shtesë në paga dhe shpërblimet financiare për stafin ekzistues të RTK-së. Kjo praktikë ishte identifikuar qartë në raportin e ZKA-së 2019-2021 dhe të cilën RTK e re ishte përkushtuar ta ndërronte.

Por, bordi i tanishëm e kishte toleruar menaxhmentin e tanishëm i cili deri në qershor të vitit 2022 dha shpërblime dhe shtesa për të punësuarit pa miratimin e bordit, edhe pse e pati kërkesën e qartë nga komisioni parlamentar për buxhet që RTK duhet të shkurtonte shpenzimet në paga për shkak se 80% e gjithë buxhetit të RTK-së shpenzohet në paga.

Fakti i pretenduar nga RTK: Në asnjë mbledhje, komisioni për buxhet, punë dhe transfere nuk ka kërkuar që të mos paguhen orët shtesë, puna e natës, apo shujta për punëtorët. Mbi çfarë baze është bërë ky konstatim nga znj. Xharra? Në cilën mbledhje na është kërkuar nga Komisioni që të shkelim ligjin e punës? Edhe sikur të kishim kërkesë të tillë, kjo do të ishte kundërligjore. Në rastin e fundit, si do të mund të kompenzoni stafin për angazhimin në veri të vendit. Prandaj, vendimi i Bordit ka qenë meritore dhe ka mundësuar zbatimin e ligjit. Bordi dhe Menaxhmenti janë vënë në dijeni për vendimin e vitit 2019, me publikimin raportit të ZKA-së dhe 5 ditë më pas është marr vendimi për shfuqizim.

Sqarimi i KALLXO.com

Në pretendimin e tretë të juaj, ju qëllimshëm i ngatërroni termet dhe e keq-interpretoni atë që ne e kemi raportuar.

Ju në “Pretendimi i 3 nga kallxo.com” të demantit tuaj thuani “Fakte: Në asnjë mbledhje, komisioni për buxhet, punë dhe transfere nuk ka kërkuar që të mos paguhen orët shtesë, puna e natës, apo shujta për punëtorët.”

As shkrimi ynë nuk thotë që nuk duhen të paguhen orët shtesë, puna e natës apo shujta! Shkrimi rikujton faktin që juve në gati çdo mbledhje të komisionit parlamentar për buxhet dhe financa ju është ngritur problemi që një shumë e madhe e buxhetit harxhohet në paga. Më saktësisht lexojeni [transkriptin](#) e njëjës prej këtyre mbledhjeve në të cilën deputeti Pal Lekaj thotë “70% e buxhetit të RTK-së shpenzohen për paga. Nëse marrim për investime kapitale është minimumi edhe pse kërkesat janë

enorme dhe prapë kemi ngecur". Më tutje Besnik Boletini e konfirmon "Me këtë buxhet ku 80% e mjeteve shkojnë për paga, është e vështirë të bëhen investime kapitale".

Kjo është vetëm një shembull, e ka edhe plot të tjerë ku deputetët ju kanë bërë vërejtje për buxhetin e madh që shpenzohet në paga e ju, sipas Auditorit, në vend se t'a zvogëloni përqindjen e buxhetit të RTK-së që harxhohet në paga, ju keni bërë shpërblime në paga mujore për punëtorë të caktuar. Ne kemi raportuar se "bordi i tanishëm e kishte toleruar menaxhmentin e tanishëm i cili deri në qershor të vitit 2022 dha shpërblime dhe shtesa për të punësuarit pa miratimin e bordit"- është fjala për çështjen në faqen 21 të [raportit](#) të Auditorit.

Çështja 1

Mos zbatimi i vendimit për ndalesat e shpërblimeve dhe shtesave

Gjetja

Gjatë auditimit, në tre (3) raste edhe këtë vit kemi vërejtur se RTK-ja kishte paguar shpërblime për punonjës. Këto ishin dhënë për arsye të ngarkimit të punonjësve me autorizime për ushtrimin e funksioneve të caktuara. Në tri rastet kemi vërejtur se autorizimet e dhëna ishin për pozita të cilat nuk ishin pjesë e rregullores për metodologjinë e përcaktimit të ndërlíkueshmërisë në punë mirëpo ishin pjesë e organogramit. Kosto e shpërblimeve për këta persona ishte 6,419€. Për këto lëvizje të stafit në pozita nuk ka dëshmi se ka pasur miratim nga bordi i RTK-së. Kjo çështje kishte ndikim deri më datën 07.06.2022.

Sa për rikujtim, Rregullorja [PËR KOMPENSIM/SHPËRBLIM PËR TË PUNËSUARIT NË RTK](#) në nenin 3 thotë se Shpërblimi është "Të hollat që i jepen punëtorit të rregullt të RTK-së, për arritje të larta ose për suskese të mëdha në punë."

Pretendimi 4 nga z. Ahmetxhekaj

Fjala është për vendimin që Ahmetxhekaj e kishte marrë më 1 shtator 2022 kur Arsim Halilin e kishte "autorizohet që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës "ndihmës i drejtorit të përgjithshëm të RTK2" duke i caktuar, me një vendim arbitrar, pagën në vlerë prej 1404 euro.

Fakti sipas RTK: Kush e ka konstatuar se është vendim arbitrar? Në çfarë vendimi thirreni se Drejtori i Përgjithshëm ia ka caktuar pagën dhe se pozita e ndihmësit nuk është në organogram? Kjo pozitë ekziston në organogram, në nenin 33 të Rregullores për Kompetenca dhe Përgjegjësi (<https://ëëë.rtklive.com/sq/docs/archive/40.pdf>) dhe poashtu edhe koeficienti është i përcaktuar. (Bashkangjitur keni dokumentet).

Sqarimi i KALLXO.com

Në fakt rregullorja që na e keni dërguar nuk e cekë koeficientin e kësaj pozite. As "Metodologjia e Përcaktimit të Ndërlíkueshmërisë së Vendeve të Punës" që është rregullorja tjetër e katalogut të vendeve të punës e cila është bazë për ndërtimin e strukturave organizative të RTK-së, nuk e cekë se sa duhet të paguhet kjo pozitë.

Përcaktimin e pagës për këtë pozitë, Rregullorja për Kompetenca dhe Përgjegjësi ia ka lënë në kompetencë Drejtorit të Përgjithshëm me e negociu me "Ndhmësin e drejtorit të përgjithshëm për RTK 2 TV", pasi aty thuhet se "Pagat... ndihmësit të Drejtorit të Përgjithshëm për RTK 2 TV... të përcaktuar në Nenin 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, do të negociohen jashtë listës për harmonizimin horizontal të vendeve të punës me Drejtorin e Përgjithshëm".

Tutje në pikën 4 të nenit 9 të kësaj rregulloreje thuhet "Kriteret për negociimin e pagës për Kryeredaktorët, Ndhmësin e Drejtorit të Përgjithshëm për RTK 2 TV... janë: ndërlíkueshmëria e vendit

të punës, vëllimi i punës, shkalla e përgjegjësisë, profesioni deficitar, përvoja e kandidatit në fushën e veprimtarisë së tij dhe specifikat e vendit të punës”.

Pra, nëse keni ndonjë dokument tjetër që e cekë saktë që kjo pozitë ka koeficient të caktuar që e arsyeton kalkulimin prej 1,404 euro, lirisht na e dërgoni, sepse rregullorja që na keni dërguar nuk e specifikon as pagën e as koeficientin.

Përndryshe, nëse nuk kemi ndonjë dokument që e arsyeton këtë pagë ne do të përdorim shprehjen ‘arbitrar’ sepse, nëse e konsultoni fjalorin arbitrar i bjen: “mbiemër; që caktohet rastësisht; që bëhet sipas dëshirave a tekave të dikujt: vendim arbitrar; qëndrim arbitrar; / që vepron me kokë të vet: njeri arbitrar.”

Përfundim: Duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet tuaja dhe duke qëndruar në plotni mbrapa artikullit tonë z. Ahmetxhekaj kërkojmë nga ju që menjëherë konform ligjit për shpifje dhe fyerje të distancoheni nga akuzat e pabazuara për organizatën tonë sidomos për pjesën e financimit dhe siç e quani ju “përfitimit të 2.2 milion eurove”. Në të kundërtën ne jemi të obliguar që për shpifje të tilla të ndërmmarrim masa ligjore për të mbrojtur organizatën nga shpifjet dhe dëmtimi i reputacionit.

Ju njoftojmë z. Ahmetxhekaj se reagimi juaj është publikuar në hapësirën Letër Redaksisë dhe në tekstin bazik do të shënohet linku ku është publikuar reagimi. Po ashtu përgjigja jonë është publikuar në Letër Redaksisë. Kërkojmë nga ju që në rast se RTK publikon reagimin tuaj ta publikojë edhe përgjigjen tonë.